

# AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

## ***Çfarë është një vlerësues i dëmeve në sigurime?***

Vlerësuesi i dëmeve në sigurime është personi i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vlerësimin e dëmeve të ndodhura si pasojë e një ngjarje sigurimi. Procesi i vlerësimit përfshin mbledhjen e të dhënave dhe përlllogaritjen e shumës që duhet të paguhet nga shoqëria e sigurimit për dëmet, si rezultat i ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.

## ***Kush mund të ushtrojë veprimtarinë e vlerësuesit të dëmeve në sigurime?***

Veprimtaria e vlerësuesit të dëmeve në sigurime mund të ushtrohet vetëm nga personat fizikë apo juridikë të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Të dhënat mbi vlerësuesit e dëmeve të licencuar publikohen në faqen online të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, në linkun <http://www.amf.gov.al/tsigurimeve.asp?id=4&r=1>

Vlerësuesit e dëmeve mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre si punonjës të shoqërisë së sigurimit ose si vlerësues të pavarur dëmsh.

## ***Cilat janë shërbimet që marrim nga një vlerësues i dëmeve?***

Vlerësuesit e dëmeve, bazuar në treguesit dhe koeficientët e përcaktuar nga Institucionet kompetente për përcaktimin e shkallës së dëmtimit, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi, përcaktojnë në mënyrë profesionale dhe të paanshme shumën e dëmshpërblimit që shoqëria e sigurimit detyrohet të paguajë ndaj personave të siguruar, për dëmet si rezultat i ndodhjes së ngjarjes së sigurimit, deri në limitin e përgjegjësisë të përcaktuar sipas kontratës së sigurimit.

## ***Parimi bazë***

Vlerësuesi i dëmeve kryen vlerësimin në mënyrë të paanshme dhe të pavarur, duke respektuar parimin një vlerësim për një ngjarje sigurimi.

## ***Ku mund të gjej më shumë informacion mbi vlerësuesit e dëmeve në sigurime?***

Më shumë informacion mbi vlerësuesit e dëmeve në sigurime do të gjeni në faqen web të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al) ose duke na kontaktuar në: [konsumatori@amf.gov.al](mailto:konsumatori@amf.gov.al); tel: +35542257557/tel pa pagesë: 08006969 & sms: +355694060671.